



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Atelier 4” të datës 10.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Atelier 4” të datës 09.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “Atelier 4” (tutje “parashtruesi”) me datë 10.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për ndërtimin Memoriali Përkujtimor Adem Jashari - Ritender” me nr. të prokurimit 616-25-11469-4-1-3.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

**Duke pasur parasysh se nuk na është lejuar qasja në dokumentacionin administrativ dhe kualifikues të operatorit ekonomik fitues, aktualisht nuk kemi mundësi të verifikojmë nëse këto kërkesa janë përmbushur, gjë që përforcon nevojën për rivlerësim**

**Dyshimet tona lidhur me ligjshmërinë e procesit të vlerësimit dhe përmbushjen e kritereve nga operatori ekonomik fitues janë thelluar edhe më tej për shkak të mungesës së transparencës dhe kufizimit të qasjes në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit. Pavarësisht kërkesave tona të përsëritura për qasje në dokumentacion, si dhe përkundër faktit se përmes komunikimeve zyrtare me email na është konfirmuar se mund të shqyrtonim dokumentacionin e operatorit ekonomik fitues, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundësuar qasje efektive dhe të plotë në dokumentet relevante.**

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit duhet sqaruar se parashtruesi nuk është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit por është përzgjedhur në vendin e dytë. Ndërsa vlerësimi i pikëve sipas të cilave parashtruesi nuk është përzgjedhur në vendin e parë, është bërë nga një komision profesional dhe objektiv. Përndryshe as vet parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk ka prezantuar pretendimet ankimore konkrete apo argumente të matshme dhe të ligjshme përmes të cilave do të mund të konfirmoj ndonjë epilog ndryshe.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 12.06.2026**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.